

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË “DREJTORINË ARSIMORE RAJONALE”.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë me objekt “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiar” për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 39, datë 25.4.2016. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën Nr. 1129/5, datë 25.04.2016, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z Arjola Byzyka, Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

### **A. PROPOZIM PËR PËRMIRËSIM KONTRATE PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

1.Nga auditimi i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë, u konstatua se norma mësimore e mësuesve që aktivizohen me drejtimin e organizatave të sindikatave është e reduktuar. Kështu për seksionet sindikale në qarqe, që kanë më shumë se 600 anëtarë, drejtuesve të sindikatave u reduktohet norma mësimore javore me 5-10 orë në javë dhe për një person të dytë me 6-8 orë në javë, kjo në referencë të nenit 13.4 të Kontratës Kolektive të Punës datë 16.12.2015, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit e Sportit nga njëra anë dhe Federatës të Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës e Sindikatës së Pavarur Arsimit të Shqipërisë nga ana tjetër, ku përcaktohet se, për të krijuar mundësinë e marrjes pjesë në veprimtarinë sindikale, drejtuesve të këtyre organizatave, u reduktohet ngarkesa mësimore javore nga 5-10 orë në javë, si rregull sipas numrit të anëtarësisë me kuotizacion. Masa konkrete e reduktimit të ngarkesës mësimore javore, për çdo drejtues seksioni vendoset me marrëveshje midis dy sindikatave dhe u njoftohet drejtorive arsimore rajonale, në fillim të çdo viti mësimor. Referuar nenit 181, pika 7, germa “c” të Ligjit nr.7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime, përcaktohet qartë se punëdhënësi duhet t’u krijojë kushtet dhe lehtësitë e nevojshme përfaqësuesve të zgjedhur të organizatave të punëmarrësve dhe konkretisht “*...t’u japë kohën e nevojshme për të marrë pjesë në veprimtaritë e këtyre organizatave brenda dhe jashtë vendit*”. Nisur nga përmbajtja e këtij neni, përcaktohet qartë se, drejtuesve sindikalë duhet t’u jepet koha e nevojshme për të marrë pjesë në veprimtaritë e brendshme e të jashtme, veprimtari që nuk zhvillohen çdo ditë të vitit por vetëm disa herë në vit, sipas aktiviteteve që kanë sindikatat. Në vështrim të Kodit të Punës, neni 181, përfaqësuesve të zgjedhur është normale t’u lejohet shkëputja nga procesi mësimor, sa herë të ketë veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, por jo çdo ditë të vitit pasi ka një efekt mjaft të ndjeshëm po të kalojmë në nivel vjetor.

2.Nga auditimi i transaksioneve nëpërmjet dokumentacionit të bankës u konstatuan xhirime vlerash monetare për llogari të Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë (FSASH) dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH) për shuma të barabarta, bazuar në totalin e ndalesave nga pagat të punonjësve dhe mësuesve të DAR-it, për kuotazicionet sindikaliste. Ajo që konstatohet është se kjo njësi shpenzuese buxhetore është kthyer në një agjenci shërbimesh për llogari të dy sindikatave që kanë lidhur marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, duke përballuar shpenzimet e kryerjeve të këtyre veprimeve nga buxheti i shtetit, pasi janë rreth 4000 mësues e punonjës të DAR-it, për të cilët mbahet kuotizacioni dhe bëhen veprimet për kalimin në llogari të subjekteve sindikaliste. Edhe marrëveshja për ndarjen e

kuotizacioneve në mënyrë të barabartë mes FSASH dhe SPASH, i referohet formalitetit të këtyre procedurave dhe aq më tepër të aktivitetit sindikal.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrë masë për rishikimin e nenit 13, pika 4, të Kontratës date 16.12.2015, të lidhur me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës e Sindikatës së Pavarur Arsimit të Shqipërisë, duke hequr reduktimin e normës mësimore për përfaqësuesit e zgjedhur por duke krijuar mundësinë e dhënies së lejes në rastet kur ka veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim që neni 13, pika 4 e kontratës së sipërcituar të mos bie ndesh me ligjin nr.7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, neni 181, pika 7, germa “c”.

2. Në kontratë të sanksionohet nëse mbledhja e detyrimeve sindikale do të bëhet nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit, të bazohet në numrin e subjekteve që paguajnë kuotizacion, me qëllim ndarjen e saktë të detyrimeve dhe jo në raport të barabartë mes tyre përcaktuar në marrëveshje.

**Menjëherë**

**B. MASA ORGANIZATIVE**

1. Në programet buxhetore zëri kryesor është zëri i pagave, në vlerën 2,615,619 mijë lekë dhe krahasuar me vitin 2014 shuma e programuar është rritur me 240,991 mijë lekë. Duke ju referuar realizimit të buxhetit të vitit 2015, rezultoi se zëri i pagave dhe sigurimeve shoqërore kanë nivelin më të lartë të fondeve 99.9%. Lidhur me programimin e shpenzimeve nën artikullin 602, ato janë në shumën 23,452 mijë lekë dhe krahasuar me vitin 2014 konstatohet një rritje me 12,594 mijë lekë. Likuidimet për detyrime të prapambetura (për vitin 2014) kapim vlerën e 15 milionë lekëve dhe i takojnë pagesave të prapambetura të sigurimeve shoqërore për periudhën 2009-2013, ndërkohë që nuk u konstatua përcaktim përgjegjësish për këto detyrime.

Gjatë vitit 2015, fondet në dispozicion janë ndryshuar, me shtesa dhe paksime të shpenzimeve nga Ministria e Financave. Për tu theksuar, janë miratimet nëpërmjet fondit të veçantë për subvencionin e blerjeve të librave nga nxënësit rom, të nxënësve që prindërit i kanë me gjendje të keqe ekonomike dhe me sëmundje të gjata, të shpërblimeve të punonjësve që dalin në pensione, të punonjësve që janë me sëmundje të gjata dhe të rënda si dhe rastet për fatkeqësi, fonde që kapin vlerën 28,061 mijë lekë në vitin 2015 dhe krahasuar me periudhën e mëparshme ato janë rritur me 2,196 mijë lekë.

Shpenzimet operative paraqiten me mosrealizim në masën 19,746 mijë lekë krahasuar me planin fillestar. Në këtë mosrealizim ka ndikuar fakti që megjithëse fondet janë çelur për këtë njësi shpenzuese, shpenzimet për internet janë përballuar nga MAS, pasi tenderin, nënshkrimin e kontratës, zbatimin dhe likuidimin e saj, e ka bërë direkt kjo ministri. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr.8-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga ana DAR Tiranë të bëhet analizë për diferencat e rezultuara midis programimit dhe zbatimit të zërave buxhetorë gjatë periudhës. Të merren masa që në të ardhmen programimi të shoqërohet me analiza të qarta, me qëllim përdorimin e fondeve publike deri në maksimum, në mënyrë që të minimizohen ndryshimet në zërat buxhetor gjatë vitit.

**Menjëherë**

2. Nga auditimi i transaksioneve nëpërmjet dokumentacionit të bankës u konstatua se për llogari të Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë (FSASH) dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH) janë kaluar shuma të njëjta bazuar në ndalesën prej

100 lekë në muaj për çdo mësues të DAR Tiranë, për kuotizacionet sindikaliste. Ajo që konstatohet është se, ky veprim i DAR-it nuk ka asnjë mbështetje ligjore për sa kohë që në kontratën nr. 10839, datë 16.12.2015 lidhur mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, nuk është parashikuar më kryerja e një veprimi të tillë. Po kështu konstatohet se bazuar në një kontratë me Shoqatën “Kursim Kredie-Mësuesi”, institucioni është i detyruar të bëjë rolin e agjentit për detyrime të kredive të marra nga mësuesit. Vlerat e llogaritura dhe të transferuara për llogari të shoqatës janë në vlera të konsiderueshme. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 19-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

DAR Tiranë të ndërpresë mbledhjen e kuotizacioneve të anëtarësisë së subjekteve sindikalë duke i njoftuar më parë ato dhe njëkohësisht mësuesve të cilëve nuk do t’iu mbahet më kuotizacioni të respektohen kërkesat e Kodit të Punës.

Nga DAR Tiranë, të merren masa për ndryshimin e kontratës me Shoqatën “Kursim Kredie-Mësuesi” duke kërkuar që të hiqet detyrimi për të bërë ndalesat nga paga dhe transferuat për llogari të mësuesve të veçantë. Ndryshimet e mundshme ti komunikohen mësuesve në mënyrë që të mos krijohen kosto shtesë për ata për shkak të padijenisë.

#### **Menjëherë**

**3.** Gjatë auditimit të kryerjeve së pagesave për trajtimin financiar (dieta dhe fjetje) dhe për bileta transporti të disa punonjësve (arsimtarëve), që kanë shkuar me shërbim brenda vendit, jashtë qendrës së punës, gjatë periudhave të maturës shtetërore, rezultoi se janë kryer në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi. Kështu konstatuam se biletat e transportit, janë paguar për vlerën e plotë të fiksuara tek biletat e paraqitura pa patur parasysh Urdhrat nr. 125, datë 26.12.2011 të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit “*Për miratimin e hartave të azhornura të rrjetit rrugor kombëtar dhe të distancave kilometrike të udhëtarëve*”, si dhe VKM nr. 66, datë 7/02/2007 “*Për disa ndryshime në VKM nr. 146, datë 26/02/1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve*”, të ndryshuar.

Gjithashtu pagesat për trajtimin financiar (dieta dhe hotele për fjetje), të punonjësve që janë dërguar me shërbim brenda vendit, jashtë qendrës së punës, në qytetet që kanë largësi nën 100 km janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, i ndryshuar. Konstatuam pagesa të pa plotësuara me praktika të plota dokumentare. Kishte raste të urdhër shërbimeve pa u vendosur llogaritjet e shpenzimeve, raste të llogaritjeve të shpenzimeve në urdhërshërbimet por bashkëlidhur kishte praktika të tjera dokumentare (bileta, fletë hotelesh), që nuk ishin njohur si shpenzime. U konstatuan edhe raste të kryerjeve të pagesave për trajtim financiar me dieta pa u shoqëruar me autorizim përkatës, pavarësisht se kishte urdhër nga ministria për të marrë pjesë në komisionet e provimeve të maturës shtetërore. Kështu u konstatuan 20 raste në vlerën 21,097 lekë. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

DAR Tiranë të marrë të gjitha masat për të ardhmen, që distancat ndër qytetëse si dhe distanca mbi 100 km nga qendra e punës të merren vetëm nga Urdhri i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit nr. 125, datë 26.12.2011 si dhe tarifave e çmimeve të biletave të merren vetëm nga VKM nr. 66, datë 7.02.2007 “*Për disa ndryshime në VKM nr. 146, datë 26/02/1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve*”, të ndryshuar si dhe të ndërpritet trajtimi financiar me dieta dhe hotele të punonjësve për qytetet, që janë nën 100 km nga qendra e punës, në respektim të VKM nr. 997, datë 10.12.2010, i ndryshuar.

DAR Tiranë, të mos kalojë pagesat për trajtim financiar të punonjësve, që shkojnë me shërbime, pa u plotësuar formularët e shërbimeve me të gjitha kërkesat, si: llogaritjet përfundimtare të shpenzimeve përkatëse në urdhër shërbimet, shoqërimi me autorizimet përkatëse nga nëpunësi autorizues për çdo dërgim me shërbim si dhe në dokumentin e urdhër shërbimeve të bashkëlidhen vetëm praktikant dokumentare, që janë përfshirë në llogaritjet e shpenzimeve. Gjithë praktikant e konstatuara me mangësi, të plotësohen me dokumentacionin përkatës.

#### **Menjëherë dhe në vazhdim**

4. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, konstatohet se listëprezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e DAR-Tiranë dhe personelin e shkollave të arsimit parauniversitar në varësi, janë bërë në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës në muaj dhe jo mbi bazën e verifikimit të prezencës në punë çdo dite, duke mos pasqyruar prezencën e mësuesve dhe punonjësve të shkollave çdo ditë të muajit, për ditët që ato kanë punuar, praktikë që nuk është në përputhje me piken 69 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Sipas bazës ligjore të mësipërme “Listpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer”. Megjithëse, u audituan elementet e pagave të personelit mesimor, nuk ishte e mundur të auditohen dokumentet e dosjes së mësuesve, pra edhe dokumentet për ndryshimet në kategori, vjetërsia në punë etj.

Për vitin 2014, konstatohet se janë paguar nga DAR 3687 mësues për të cilët kosto e punës është 2,7 milionë lekë, ndërkohë që për vitin 2015 janë paguar 4120 mësues dhe kosto e punës është 3,1 milionë lekë. Në këtë kosto përfshihet edhe fondi i veçantë, planifikimi dhe përdorimi i të cilit është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 185, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.3, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014” dhe Ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për arsimin parauniversitar” i ndryshuar, ku përcaktohet “përdor një fond të veçantë vjetor nga buxheti i njësisë arsimore vendore për shpërblimin për merita profesionale të mësuesve, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, pas këshillimit me partnerët social dhe bordin e institucionit”

Për vitin 2014, është përdorur një fond prej 10,760 mijë lekë, për shpërblimin e 269 mësuesve nga arsimit mesimor. Për shpërblimin e nxënësve me rezultate të shkëlqyera në ciklin e dytë të sistemit 9-vjeçar, VKM nr. 861, datë 17.12.2014 “Për shpërblimin dhe kompensimin e disa kategorive të veçanta për festat e fund vitit”, në piken 1 ka përcaktuar masën e shpërblimit 5 mijë lekë për secilin. Janë shpërblyer gjithsej 1761 nxënës. Nuk ka pasur shpërblim për mësuesit e ciklit 9 vjeçar. Ndërsa për vitin 2015, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë Vendimin me nr. 1083, datë 28.12.2015 “Për shpërblimin dhe kompensimin e disa kategorive të veçanta për festat e fund vitit”. Në zbatim të këtij vendimi, MAS ka dërguar në DAR të Qytetit Tiranë, shkresën me fondin limit për shpërblimin e 50 mësuesve të dalluar, në vlerën totale 2 milion lekë. Gjithashtu, është akorduar fondi 5,235 mijë lekë për shpërblimin nxënësve të dalluar të sistemit parauniversitar.

Nga auditimi për pagesën për orët suplementare të mësuesve, konstatuam se nga 15 shkolla të arsimit mesimor gjithsej në qytetin e Tiranës, janë paguar orë suplementare në 7 prej tyre. Kanë përfituar orë suplementare 21 mësues, për gjithsej 1031 orë, nga ku u konstatua që për një mësues janë paguar deri në 100 orë mbi normë. Nuk u bë auditimi i pagesave për orë suplementare të mësuesve për shkollat 9 vjeçare, për shkak të ngarkesës së llogaritjeve që kërkonte ky proces. (trajtuar më hollësisht në faqen nr.9-17 të Raportit të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga ana e DAR Tiranë, të merren masa për t'iu larguar praktikës së plotësimit formal të listë prezencave dhe të forcohen sistemet e kontrollit për institucionet në varësi. Listprezencat për punonjësit e DAR Tiranë dhe për mësuesit e punonjësit e shkollave të qytetit të Tiranës që mbulohen nga ky institucion, të plotësohen çdo ditë dhe të paraqiten në fund të muajit për plotësimin e listpagesave, duke shërbyer si dokumentacioni bazë për shërbimin e kryer, llogaritjen e pagës për nxënësit e punonjësit e shkollave.

Për shkak të kapaciteteve të kufizuara në këtë auditim, kërkohet nga DAR-i të bëhet verifikim i plotë i orëve suplementare të dhëna sipas shkollave dhe në përfundim materiali të dërgohet edhe pranë KLSH.

Të ngrihen sisteme kontrolli të brendshëm lidhur me monitorimin e ngarkesat mësimore të mësuesve dhe ndjekjen korrekte të ankesave lidhur me këtë aspekt.

DAR Tiranë, në mënyra të vazhdueshme të ndjekë dokumentacionin e personelit mësimor për kalimin nga një kategori e ulët në më të lartë dhe të ndryshimeve të vjetërsisë në punë, për efekt të pagesës.

### **Menjëherë**

**5.** Nga auditimi i organizimit dhe mbajtjes së bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare u konstatua se për zërin “Studime dhe kërkime” nuk ka llogaritje të amortizimit. Zëri “Derdhje buxhet të të ardhurave pa përdorura” dhe zëri “Derdhje të të ardhurave në buxhet” kanë pasaktësi për vlerën 522,884 lekë të paraqitur tek Formatin nr. 3/1. Kjo vlerë duhet të ishte kaluar në zërin “Derdhje të të ardhurave në buxhet”, pasi këto të ardhura janë derdhur në buxhet, pra nuk janë të ardhura pa u përdorur. Në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”, për 13 pozicione konstatohet një saldo debitorë në vlerën totale prej 8,481,494 lekë, për debitor të krijuar nga mungesa në inventarizime, vjedhje të pasurisë shtetërore nga element keqbërës si dhe detyrime të krijuara nga auditimet e bëra nga Ministria e Arsimit si dhe KLSH-ja, para viteve 2005. Për arkëtimin e këtyre debitorëve të shpallur nga njësia shpenzuese si debitor pa shpresë arkëtimi, nuk janë bërë veprime për vjeljen e tyre që nga viti 2005. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr.24-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

DAR Tiranë, të marrë të gjitha masat për të ardhmen duke filluar, që me nxjerrjen e bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare të vitit 2015, të llogarisë me saktësi amortizimin si për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara edhe për aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara. Të paraqiten me saktësi derdhjet e të ardhurave në buxhet në llogarinë “Derdhje të të ardhurave në buxhet”.

DAR Tiranë, vlerën e debitorëve pa shpresë arkëtimi ta paraqesë në një llogari jashtë bilancit, duke vazhduar edhe përpjekjet për të realizuar vjeljen e detyrimeve qoftë edhe me rrugë gjyqësore, pasi të konsultohet edhe me Avokaturën e Shtetit. Ndërkohë të nxirret përgjegjësi për mosveprim që ka lejuar që këto detyrime të kthehen në detyrime pa shpresë arkëtimi.

### **Duke reflektuar që me plotësimin e bilancit 2015 dhe vazhdim**

**6.** Gjatë auditimit të krijimit të mallrave stoqe, u konstatua se në aktivin e bilancit kontabël, llogaria/35 “Mallra” paraqitet me vlerë **4,453,819 lekë**. Kjo vlerë përfaqëson libra stok, të ndara për arsimin e mesëm me vlerë 3,552,167 lekë dhe për arsimin bazë me vlerë 901,652 lekë. Këto libra ndodhen gjendje në magazinë, që nga viti 2002, 2003, 2004 dhe 2005, duke mbetur stok pasi janë jashtë curricul-ave (jashtë programit mësimor), e për pasojë nuk kanë vlera përdorimi. Aktualisht këto libra janë sistemuar në disa dhoma klasash të Shkollës Vasil Shanto. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr.26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

DAR Tiranë në bashkëpunim me MAS për këtë sasi të librave stok, të marrë masa konform legjislacionit në fuqi, për ti shpërndarë në bibliotekat e shkollave në shkallë republike dhe në pamundësi të kësaj procedure të realizojë nxjerrjet jashtë përdorimit të tyre, duke e shoqëruar procesin edhe me një analizë të shkaqeve dhe reflektim në praktikat aktuale, për të mos u përballur me situata të ngjashme në të ardhmen.

**Menjëherë**

**7.** Gjatë auditimit të pagesave të kryera për llogari të Kompanisë “Albtelekom” për përdorim të numrave telefonik fikse nga punonjësit e DAR-it, u konstatuan raste të kryerjeve të pagesave të vetëm të kuotave fikse të shërbimeve, çka tregon se këto numra telefonash nuk janë në përdorim duke sjelle edhe kryerje shpenzimesh pa efektivitet.

Gjithashtu u konstatuan edhe raste të cilësimeve në faturën e Albtelekomit përveç kuotës së shërbimit edhe vendosje vlerash për përdorim të lidhjeve me internet të ADSL, sipas rasteve me, vlera të cilat nuk paguheshin nga kjo njësi shpenzuese (DAR), por vetëm kuota e shërbimit mujor, ndërkohë që DAR-T ka paguar dhe kontratën e shërbimit me Abissnet për lidhjet me internetin. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

DAR Tiranë, të shikojë mundësinë e mbylljes së përdorimit të numrave telefonik fikse, që nuk janë në përdorim, me përjashtim të sekretarisë së institucionit, si dhe të rakordohet me Kompaninë “Albtelekom” për të mos pranuar shërbim të ADSL-së në faturimet përkatëse, për sa kohë shërbimi ofrohet nga një subjekt tjetër.

**Menjëherë**

**8.** Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpërblimin e mësuesve për festat e fundvitit, për vitet 2014, 2015, është konstatuar parregullsi në llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat. Tatimi mbi shpërblimin e mësuesve të dalluar, është mbajtur në masën 15%. Ky veprim nuk është i mbështetur në ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, date 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, pika 2. Për shpërblimin e përfutur, të ardhurat taten duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës, sipas shembullit të Udhëzimit. Në piken 2.3.1 janë përcaktuar të ardhurat nga punësimi si paga dhe shpërblime, mbi të cilat mbahet tatimi. Sipas tabelës bashkëlidhur ndryshimeve të bëra në ligjin për tatimin mbi të ardhurat (tabela bashkëlidhur ligjit nr.177/2013, datë 28.12.2013), për të ardhurat nga paga e shpërblime, në vlera deri në 130 mijë lekë, tatimi llogaritet në këtë mënyrë: deri në 30 mijë lekë, tatimi është zero, 30,001-130,000 lekë tatimi mbi të ardhurat llogaritet në masën 13%.

Nga moszbatimi i kërkesave të ligjit mbi tatimin në të ardhurat e mësuesve të shpërblyer, këtyre të fundit u është mbajtur më tepër 2% mbi vlerën e llogaritur të pagës me shpërblimin. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr.9-17 Raportit të Auditimi).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Për rastet e shpërblimit që u bëhet mësuesve dhe punonjësve të dalluar në shkollat e varësisë të DAR qyteti Tiranë, për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat, të zbatohen me rigorozitet kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, date 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

**Vazhdimisht**

9. Nga auditimi i dosjeve me dokumentet e punës e të vlerësimit të punonjësve, u konstatuan mangësi e parregullsi, dokumente fotokopje e të pa noterizuara, mungesa lidhur me vlerësimin periodik të punës së punonjësve etj. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 9-17 të Raportit të Auditimit).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Spektori i Programeve të Zhvillimit në DAR qyteti Tiranë, të marrë masa për plotësimin e dosjeve individuale të punës me dokumente që mungojnë ose që nuk janë të rregullt.

Dosjet të plotësohen me vlerësimin vjetor të punës të punonjësve për punën e kryer dhe të bëhet dokumentimi i tij.

**Vazhdimisht**

10. Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, për kryerjen normal të aktivitetit të institucionit, konstatohet se në strukturën e tij, nuk janë parashikuar pozicionet “magaznier” dhe “arshivist”, detyra të cilat u janë ngarkuar punonjësve të tjerë. Për të siguruar administrimin më të mirë të materialeve në inventar dhe të dokumenteve të arshivës, të cilat janë në numër të madh, kërkohet që këto vende pune të mbulohen nga punonjës të përfshirë në strukturën organike.

Në lidhje me problemet për administrimin më të mirë të fondeve e të mirave materiale, u vërejt se njohuritë për termat ekonomik e financiar të punonjësve të institucionit (shumica e të cilëve janë mësues), kishin mangësi. *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 35-38 të Raportit të Auditimit).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të merren masa që punonjësit të kenë njohuritë e nevojshme për të siguruar administrim efektiv të fondeve dhe zbatim korrekt të kërkesave për një menaxhim financiar të kujdesshëm, duke përshtatur detyrat funksionale me përgatitjen e tyre profesionale. Të kërkohen trajnime plotësuese në fushën e administrimit dhe menaxhimit financiar me qëllim rritjen e njohurive për termat ekonomik dhe financiar që lidhen me administrimin e mirë të fondeve dhe të mirave materiale.

Të ketë një ndarje të kujdesshme të detyrave brenda stafit të institucionit për të siguruar një mbulim të plotë për funksionimin e arkivit dhe magazinës.

**Menjëherë**

**C. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV, pika 93, nga titullari i DAR-T të nxirren aktet administrative në mënyrë që të kërkohet shpërblimi i dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën totale **301,551** lekë, nga personat më poshtë, sipas nenit 640 të Kodit Civil, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi:

1. Vlera **248,541** lekë, nga znj. [REDAKTUAR], me detyrë ish Drejtore e DAR-T, për llogaritje të pajustificuar dhe të pa argumentuar të karburantit të llojit “benzol pa plumb”, në vlerën 183,210 lekë pa TVSH, në kushtet kur institucioni nuk ka nevoja për këtë lloj karburanti si dhe për shpenzimin e karburantit të tërhequr dhe konsumuar në sasinë 357 litra, në vlerën 65,331 lekë, i pa justifikuar me dokumentacionin përkatës si, fletë udhëtimin e mjetit etj.

2. Vlera **53,010 lekë me TVSH** nga [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për llogaritjen më tepër të fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 66, datë 7.2.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave ”Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve” i ndryshuar, Aneksi 1, pasqyra 1 si dhe Urdhrit të Ministrit të MPPT nr. 125, datë 26.12.2011”Për miratimin e hartave të azhurnimit të rrjetit rrugor kombëtar dhe të distancave kilometrike të udhëtarëve”.

**Menjëherë**

**Shënim:** Meqenëse vlera 337,500 lekë, e konsideruar dëm në materialin e auditimit në lidhje me nxjerrjen e urdhër prokurimit dhe lidhjen e kontratës për tenderin e zhvilluar në vitin 2007, që për mungesë fondesh është likuiduar gjatë vitit 2014, pasi është llogaritur tvsh-ja në masën 20% për pajisjet dhe aparaturat në tenderin me objekt “Rikonstruksioni dhe përshtatja e ambienteve për Shkollën e Mesme Elektrike Tiranë”, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8/5/2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, u hoq si rekomandim, meqë është parashkruar, si vlerë e krijuar gjatë vitit 2006-2007. Në Raportin e auditimit kjo është marrë parasysh duke lënë shënim përkatës, në mënyrë që në të ardhmen të kihet parasysh.

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Nga titullari i institucionit të analizohet Raporti Përfundimtar i Auditimit ku të nxirren përgjegjësitë për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

**Menjëherë**

#### **E. TË TJERA PËR DREJTORINË E INSPEKTIMIT FINANCIAR (MINISTRIA E FINANCAVE)**

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2015, i regjistrit të parashikimeve, si dhe në programimin dhe realizimin e prokurimeve kemi konstatuar se janë parashikuar prokurime publike me të njëjtin objekt “blerje pajisje sportive” si për Drejtorinë Arsimore Rajonale, Qyteti Tiranë ashtu dhe për Drejtorinë Arsimore, Qarku Tiranë. Meqenëse shkollat me orientim sportiv janë në juridiksionin e Drejtorisë Arsimore Rajonale, qyteti Tiranë, mendojmë se mund të ekzistojë mundësia që të ketë mbivendosje në shpenzimin e fondeve buxhetore për të njëjtin objekt prokurimi.

Gjithashtu nisur nga niveli i lartë i fondit të veçantë për subvencionimin e blerjeve të librave nga nxënës të komunitetit rom, nxënës me prindër në gjendje të keqe ekonomike dhe me sëmundje të gjata, në pamundësi për të audituar për çdo shkollë në lidhje me këtë fond, kërkohet inspektim i tyre.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Bazuar në Ligjin nr. 112/2015 “Për Inspektimin Financiar dhe Publik”, neni 8, kërkohet nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave, verifikimi i fondeve për prokurimet publike në dispozicion të këtyre subjekteve, me qëllim evitimin e mbivendosjes së tyre dhe i subvencionit për blerjen e librave, mbi bazë kategorisë së nxënësve që përfitojnë nga ky subvencion.

**Brenda viti 2016**

**F.** Ky auditim është vlerësuar dobët, sidomos për kohën e shpenzuar në auditim, në një kohë që kjo njësi shpenzuese publike nuk ka patur fonde për investim për periudhën objekt auditimi.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit: Miranda Haxhia (përgjegjës grupi), Fadil Dekovi, Ymer Stafa dh Ildir Dervishi më tej materiali u shqyrtua nga kryeaudituesi, drejtori i departamentit juridik dhe zbatimit të standardeve dhe drejtori i departamentit.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**